

Hajrije Gashi, PhD¹

UDC: 37.091.3(497.115)

**TEKNIKAT E MËSIMDHËNIES DHE ZBATIMI I STRATEGJIVE NË
KLASË QË NXIT TË MËSUARIT**

**ТЕХНИКИ НА НАСТАВА И ПРИМЕНА НА СТРАТЕГИИ ВО
УЧИЛНИЦА КОИ ПОТТИКНУВААТ УЧЕЊЕ**

**TEACHING TECHNIQUES AND THE IMPLEMENTATION OF
STRATEGIES IN THE CLASSROOM THAT PROMOTES LEARNING**

Abstract

This study aims to investigate the combination of the use of techniques and strategies in promoting a positive classroom environment that promotes learning and that improves student outcomes in the classroom.

In contemporary teaching, a key role in improving the quality of teaching is used by teaching techniques and the implementation of strategies in creating an effective classroom environment that promotes learning. This study aims to examine and analyze the most efficient ways and strategies that teachers use to implement these techniques in practice. Through analysis and qualitative methods and instruments such as interviews, we aim to reach the most accurate conclusions about collaborative teaching, project-based learning and the use of strategies and learning styles. Also, the importance of strategies and their adaptation according to the age level and learning style of students is emphasized. The findings of the study show that the success of the techniques used by teachers during teaching depends on planning and formative assessment and the involvement of students in learning. In this paper, I will try to fully explain the role of techniques in teaching and the strategies in their implementation that teachers in Kosovo use at the lower levels of learning. Therefore, from the research context and the review and perspective of various authors, I will try to present my view on this topic.

Keywords: *Teaching techniques, strategies, Student, teacher, contemporary teaching.*

¹ Autorja është kandidat për doktoraturë (PhD candidate) në Fakultetin Pedagogjik pranë Universitetit të Tetovës

Hyrje

Një nga sfidat të cilat e kanë përcjellë fillim shekullin, sidomos në aspektin e arsimit në Kosovë, është pikërisht ndryshimi i shpeshtë i kurrikulave dhe përdorimi i modeleve të ndryshme në periudha të caktuara. Duke e pasur parasysh së në Kosovë gjatë periudhës së pasluftës është eksperimentuar mjaft në aspektin e ndryshimit të metodave në mësimdhënie, dhe natyrisht edhe të strategjive të caktuara, atëherë është dashur që në vazhdimësi të bëhën ndryshime dhe të përgatitet mësimdhënësi në zbatimin e teknikave dhe strategjive në mësimdhënie.

Roli i shkollës për jetë është shumë i rëndësishëm dhe ndikon fuqishëm në zhvillimin normal të një familje apo një shoqërie, dhe për këtë arsye edhe mësimdhënia ose mësimnxënia e ka një peshë të veçantë për të arritur qëllime të caktuara. Në kohën e sotme problemet e shkollimit dhe edukimit dalin gjithnjë e më shumë në plan të parë. Si shoqëria, ashtu edhe familja po kuptojnë seriozisht se krahas nivelit ekonomik dhe mirëqenies, krahas arsimit dhe punësimit të brezit të reja, vërehet qartë domosdoshmëria e një preokupimi serioz dhe me pikësynime të qarta për problemet e mësimin, shkollimit dhe edukimit të fëmijëve. Aq më tepër se edhe vetë bërthama bazë e shoqërisë, e kjo është familja, ka pësuar shumë ndryshime si rezultat i imponimit të kohës dhe zhvillimit në aspektin mësimor.

Ndonëse mësimi është çështje e vazhdueshme dhe jetësore, janë teknikat, metodat dhe strategjitë ato që përcaktojnë rrugën më të shpejtë dhe më kreative të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Prandaj duhet një analizë e thellë, sidomos e strategjive në përdorim, në mënyrë që të arrihet efektiviteti dhe efikasiteti në organizimin e orës apo edhe në nivelin e tërësishëm të mësimin.

Ndonëse strategjitë hartohen prej ekspertëve në arsim duke ndjekur modelet më të mira, janë mësimdhënësit ata që i vënë në funksion këto strategji, prandaj kërkohet një kujdes i shtuar për të parë se sa efektive mund të jenë ato.

Teknikat në mësimdhënie luajnë një rol të rëndësishëm jo vetëm në aspektin e përgatitjes së nxënësve, por edhe në fitimin e përvojave të domosdoshme të mësimdhënësve, prandaj ato teknika mund të jenë të llojllojshme, por që kanë vetëm një qëllim të caktuar: efektin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Shpesh teknikat në mësimdhënie ndryshojnë nga vendi në vend apo edhe nga mësimdhënësi në mësimdhënëse, megjithatë ato janë forma të përshtatshme për të arritur suksese të përbashkëta në avancimin e dijes tek fëmijët dhe në kreativitetin e mësimdhënësve që mësimi të bëhet i kuptueshëm.

1. Kuptimi dhe metodat e mësimdhënies

Mësimdhënësi sot nuk është vetëm një ligjërues klasik i lëndës së vet, por ai është edhe edukator i tërë punës edukativo-arsimore në shkollë. Prej edukimit, arsimit dhe aftësimit të tij për profesion, varet rezultati dhe

suksesi i tërësishëm i punës në shkollë. Kjo do të thotë se nga funksionimi i tij edukativ parashikohet dhe kërkohet formim i veçantë, kërkohen tipare të veçanta morale e njerëzore.²

Të jetosh dhe të zhvillohesh në kohën e cila karakteristike kryesore ka ndryshimin, d.m.th. të pajisesh vazhdimisht me njohuri të reja. Epoka në të cilën jetojmë, gjithnjë e më tepër, karakterizohet me zhvillime të shpejta, të vrullshme dhe më intensive të shkencës, teknikës e të teknologjisë, të natyrës së mjeteve të punës, por edhe të vet prodhimit. Të ekzistosh, të jetosh e të punosh në kontekst të ndryshimeve të tilla të mëdha, është e mundimshme, vetëm po që se jeta gërshetohet me të mësuar të përhershëm, dhe kjo më së shumti vlen për mësimdhënësit.³

Nga kjo tanimë duhet të shikohen metoda të caktuara të bashkëpunimit, të cilat janë të rëndësishme në mësimdhënie. Metodat e bashkëpunimit janë të shumta dhe të ndryshme, ashtu siç i cekëm edhe më lartë, por shpesh në bashkëpunimin mes mësimdhënësve dhe nxënësve, po edhe në komunikimin e përgjithshëm, përdoren një varg metodash, aplikimi i të cilave varet shumë nga situata.⁴

Ndër metodat me të preferuara janë metoda verbale dhe mënyra e realizimit, forma e ligjëratave për bashkëpunim, metoda e bashkëpunimit partnerial, aktivitetet për lexuesit, metakomunikimi (biseda për bisedën) e shumë të tjera.⁵

Bashkëpunimi në mes të faktorëve social dhe institucional të edukimit të fëmijëve nxënës, konsiderohet njëri ndër kushtet themelore dhe esenciale të fuqizimit të këtyre faktorëve si: personaliteti, edukata, zhvillimi i potencialit të tij/saj dhe shfaqja e tij, dhe paraqet mbarëvajtjen e tij në procesin e edukimit të përgjithshëm dhe përgatitjen e tij për jetë.⁶

Teknikat dhe strategjitë janë të domosdoshme tek fëmijët në mësimdhënie që nga mosha parafillore, prandaj edhe mësimdhënia e tyre duhet të jetë në përputhje me strategjitë në të cilat zhvillohet mësimi dhe organizimi në mësim. Prandaj së pari duhet shtuar kujdes te moshat e reja, në mënyrë që të kemi një zbatim të metodave të rëndësishme në aspektin e plotësimit të dijes në nivelin fillor 1-5.⁷

Është e pakontestueshme se në të gjitha shoqëritë e botës arsimi është një sfidë, e cila kërkon qasje e riqasje për të gjetur rrugët më adekuate për arsimimin dhe edukimin e brezave që do ta kenë në dorë fatin e vendeve dhe gjithë globit nesër.⁸

² Dërvodeli, 2014.

³ Hoti, 2014.

⁴ Aferdita Deva-Zuna, 2009.

⁵ Aferdita Deva-Zuna, 2009.

⁶ Pavao Brajsa, 1994.

⁷ Selmani Lefteri, 2006.

⁸ Gavoni. P, 2015.

Mësimdhënësit janë nisur në drejtimin progresist, duke u bazuar edhe në ndryshimet kurrikulare që ka paraparë shteti ynë, e sidomos në vitet e fundit.⁹ Këto ndryshime, kërkojnë zbatim adekuat të Kurrikulës së Re, por, kërkojnë edhe zhvillim profesional të përhershëm të mësimdhënësve, me qëllim që të rrisin cilësinë në fushën e arsimit.

Mësimdhënësit, shumica prej tyre kanë qasje bashkëkohore në mësimdhënie e nxënie dhe duhet çmuar puna e tyre, janë të përkushtuar, janë novatorë, kreativë dhe nxitës të ideve për arritje sa më të larta të nxënësve në klasat ku japin mësim. Ata janë bashkëpunues dhe japin e marrin ide që qojnë procesin përpara.¹⁰

Për të tillë mësues efektiv e me rezultate shembull, të cilët shndritin me punën e tyre dhe që janë margaritarë të vërtetë për edukimin e kombit të vet, secili nga nxënësit di t'i vlerësojë, secili nga prindërit dhe secila udhëheqje e një shkolle di të vlerësojë, dhe për të tillë mësimdhënës përgjërohen që të gjithë.¹¹

Sot mësimdhënësi udhëheqë nxënësin për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionet dhe me ndihmën e tij, përgatitë nxënësit që të përballen me çdo sfidë të jetës, sado e ndërlikuar që të jetë. Roli i mësimdhënësit është të orientojë proceset e të menduarit të nxënësve drejt niveleve më të larta, të kultivojnë shprehjet e zgjedhjes së problemeve dhe të marrjes së vendimeve, në kushte të reja e të panjohura më parë prej tyre.¹²

Teknikat në mësimdhënie dhe strategjitë

Mësuesit janë burim i pashtershëm në pasurim të ideve dhe materialeve të vlefshme që përgatisin për nxënësit e tyre. Por shpesh ndodh që ata të ndjehen të zhgënjyer nga metodat të cilat i përdorin në klasë ose që eksperimentojnë në kohë dhe periudha të ndryshme. Të mësuarit është vështirësi, prandaj edhe ka rëndësi të madhe se çfarë metoda përdorim për të mësuar.¹³

Së pari janë të rëndësishme metodat që i përdorim, pastaj mënyra se si do t'i përdorim ato për të arritur qëllime të caktuara. Së dyti, ka një rëndësi procesi i të menduarit të nxënësit e jo ato që përdorin mësimdhënësit. (Zeneli, 2006)¹⁴ Pra, duhet të sigurohemi që metodat e mësimdhënësve të mos jenë rutinë në klasë, ku nxënësi do e humb vëmendjen e mësimit, por të shndërrohet në një kreativitet të rëndësishëm. Së treti, metodat duhet të jenë në përputhje me interesin e nxënësit dhe në harmoni që duke kuptuar metodën e të mësuarit të arrijnë qëllimet e tyre.¹⁵

⁹ MASHT, 2017.

¹⁰ Musai. B, 2003.

¹¹ Musai. B, 2003.

¹² Musai. B, 2003.

¹³ Musai. B, 2005.

¹⁴ Zeneli, 2006.

¹⁵ Musai. B, 2005.

Metodat më të rëndësishme të mësimdhënies në klasë janë:

- Zhvillimi i fjalorit;
- Diskutimi i ideve;
- Të nxënës bashkëpunues;
- Nxitja e diskutimit;
- Të lexuarit ndërveprues;
- Nxitja për të përsosur të shkruarit;
- Paraqitja grafike e informacionit;
- Ndërtimi i shprehive mësimore etj.¹⁶

Teknikat kryesore të mësimdhënies

Ekzistojnë një numër i madh i teknikave në mësimdhënie, të cilat sot me kurrikulën e re i kanë përdorur pothuajse të gjithë mësimdhënësit në shkollë, e ku më të rëndësishme janë:

- Teknika Brainstorming (stuhi mendimesh);
- INSRT (Sistemi ndërveprues i shënjimit për të menduarit dhe leximin efektiv;
- Diskutimi në çifte dhe në grup;
- DRTA (Lexim dhe mendim i drejtuar);
- DLTA (Dëgjim dhe mendim i drejtuar);
- Pesëvargëshi;
- Kubimi;
- Ditari dypjesësh;
- Ese;
- Copëzat e përziera;
- DDM (Di / Dua të di / Mësoj);
- Tryeza e rumbullakët;
- Gushkuqi rrethor;
- Diagrami i Venit;
- Turi i Galerisë¹⁷

Teknika Brainstorming (stuhi mendimesh) është një teknikë që nënkupton bisedën në formë pyetje-përgjigjeje me nxënësit. Kjo ka të bëjë me dhënien në mënyrë të lirë të përgjigjeve nga nxënësit për një problem të shtruar në temë apo njësi.

INSRT - Emri i kësaj teknike vjen nga anglishtja (Interactive Noting System for Effective Reading & Thinking), që do të thotë: Sistemi ndërveprues i shënjimit për të menduarit dhe leximin efektiv. Aplikimi i saj përfshin tri etapat e orës mësimore, të cilat janë: Evokim, Realizim dhe Reflektim.

¹⁶ Musai. B, 2005.

¹⁷ Schader, 2015.

Diskutimi në çifte dhe në grup - është një metodë pak më tradicionale, e cila është përdorë edhe në të kaluarën. Kjo teknikë është e përshtatshme për fazën e reflektimit. Nxënësit së pari në çifte e më pas në grup diskutojnë pjesën e lexuar dhe shikohet nëse ka mospërputhje në informacione, nxirren konkluzione, krahasohen shenjat dhe diskutohen mospërputhjet.

DRTA (Lexim dhe mendim i drejtuar) është teknikë e cila fillon me lexim me zë të lartë të nxënësit apo mësimitdhënësit në paragrafë të caktuar dhe pastaj nxënësit japin mendimin e tyre të detajuar në lidhje me temën.

DLTA (Dëgjim dhe mendim i drejtuar) dallon nga DRTA në të vetmin segment se tek DRTA leximi bëhet në mënyrë individuale, ndërsa tek DLTA lexon njëri me zë (arsimtari apo një nxënës), kurse të tjerët dëgjojnë.

Pesëvargëshi - Kjo teknikë mund të përdoret në dy faza të orës mësimore, evokim dhe reflektim.

Kubimi - Qëllimi i kësaj teknike është që të nxirren sa më shumë ide për temën dhe në të përfshihen të gjithë nxënësit në njësi. Kjo ka të bëjë me prezantimin e temës, e pastaj edhe komentimin e saj në mënyrë kube apo nga të gjitha anët.

Ditari dypjesësh - Në hapin e parë nxënësit informohen për atë që do të lexojnë dhe se gjatë leximit do të merren shënime, ndërsa në pjesën e dytë u tregohet atyre që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale, ku më pas gjatë leximit në të majtë të faqes shkruajnë ndonjë imazh apo citat nga teksti.¹⁸

Ese - Me këtë teknikë shtrohet një pyetje dhe pastaj nxënësit përmes një shkrimi duhet ta argumentojnë atë.

Copëzat e përziera nënkupton teknikën ku nxënësve iu jepet një fjali e ndarë në letra, në copëza fjalësh, për të radhitur ato dhe për të formuar me to një fjali. Kjo e bën nxënësin të mendojë më shumë dhe teston reflekset mendore të tij/saj.¹⁹

DDM (Di / Dua të di / Mësoj) është një teknikë e cila përfshin tri etapat e orës mësimore. Në dërrasë të zezë vizatohet një tabelë e ndarë në tri pjesë: Shtrohet tema që do të përpunohet dhe plotësohet tabela.

¹⁸ Latifi, 2015.

¹⁹ Demokratik, 2008.

Tryeza e rumbullakët është një teknikë bashkëpunuese, me të cilën merren ide nga anëtarët e grupeve për një çështje dhe i shkruajnë ato, të cilës i përket edhe një fazë reflektimi. Kjo teknikë është një formë e shpeshtë e përdorur edhe për të diskutuar për temën dhe njësinë mësimore të ndarë në tryeza.

Gushëkuqi rrethor është variant i teknikës tryeza e rumbullakët, por dallon nga kjo teknikë, ngase te gushkuqi rrethor nuk kemi të bëjmë me të shkruar, por me një diskutim.

Diagrami i Venit është një teknikë me të cilën mund të bëhen krahasime, të nxirren të përbashkëtat dhe dallimet e dy apo më shumë dukurive, dhe në këtë aspekt përmes vizatimeve, figurave dhe fjalëve mund të nxirren përfundime.²⁰

Turi i Galerisë është një ndër teknikat më të përdorura dhe fillon në këtë formë: Nxënësit në grupe, 3 apo 4 veta, punojnë vizatime, komente etj., pastaj punimet vendosen në mure të klasës apo vend të caktuar nga mësimdhënësi. Mësimdhënësit pastaj lëvizin përmes punimeve dhe i shikojnë ato dhe në fund grupet i marrin punimet e veta dhe i rishikojnë ose krahasojnë ato.

Praktikimi i metodave dhe strategjive në klasë

Klasa është një mjedis dinamik që bashkon nxënësit nga prejardhje të ndryshme, me aftësi dhe personalitete të ndryshme. Prandaj, të jesh një mësimdhënëës efektiv, kërkon zbatimin e strategjive krijuese dhe inovative të mësimdhënies, në mënyrë që të plotësosh nevojat individuale të nxënësve.

Pavarësisht nëse kemi dhënë mësim dy muaj apo njëzet vjet, mund të jetë e vështirë të dimë se cilat strategji do të funksionojnë më mirë me nxënësit. Si mësimdhënëës, nuk ka zgjidhje ‘një madhësi i përshtatet të gjithëve’, kështu që këtu janë një sërë strategjish efektive të mësimdhënies, të cilat mund të përdoren për të frymëzuar praktikën në klasë. Disa nga strategjitë, të cilat mund t’i përshkruajmë për përdorimin e praktikave në klasë nga mësimdhënësi, janë:

- Vizualizmi apo praktika vizuale;
- Të mësuarit në bashkëpunim;
- Udhëzime të bazuara në pyetje;
- Diferencimi;
- Teknologjia në klasë;
- Menaxhimi i sjelljes;
- Zhvillimi profesional.

²⁰ Salihu, 2008.

- **Vizualizimi apo praktika vizuale** është një metodë, përmes të cilës e shndërron mësimin nga koncepte të mërzitshme akademike me përvoja teorike, në vizuale dhe praktike të të mësuarit, duke u ndihmuar nxënësve të kuptojnë se si zbatohet shkollimi i tyre në botën reale. Pra, paraqitja vizuale e punës së një mësimdhënie ndikon jashtëzakonisht shumë edhe në mësim-nxënie dhe në kuptimin që është qëllim për të përfituar nxënësi.

Shembujt përfshijnë përdorimin e tabelës së bardhë interaktive për të shfaqur foto, klipe audio dhe video, si dhe inkurajimin i nxënësve për të dalë nga vendet e tyre me eksperimente në klasë dhe jashtë saj.

- **Të mësuarit në bashkëpunim.** Mësimdhënësi inkurajon nxënësit me aftësi të përziera që të punojnë së bashku, duke promovuar aktivitete të grupeve të vogla ose të klasës së tërë. Përmes shprehjes verbale të ideve të tyre dhe përgjigjes ndaj të tjerëve, do të zhvillohen strategji krijuese dhe inovative të mësimdhënies në mënyrë që të plotësohen nevojat individuale të nxënësve.

- **Udhëzime të bazuara në pyetje.**

Mësimdhënësit bëjnë pyetje në mënyrë që të nxisin mendimet, të cilat i frymëzojnë nxënësit të mendojnë vetë dhe të bëhen nxënës më të pavarur. Inkurajimi i nxënësve për të bërë pyetje dhe për të hartuar idetë e tyre ndihmon në përmirësimin e aftësive të tyre për zgjidhjen e problemeve, si dhe për të fituar një kuptim më të thellë të koncepteve akademike. Të dyja këto janë aftësi të rëndësishme jetësore.²¹

- **Diferencimi.** Mësimdhënësit shpesh diferencojnë mësimin e tyre, duke caktuar detyra bazuar në aftësitë e nxënësve, për të siguruar që askush të mos mbetet pas. Caktimi i aktiviteteve në klasë sipas nevojave unike të të nxënësve të mësimin të nxënësve do të thotë që individët me aftësi më të larta mësimi t'ju mundësojnë edhe të tjerëve që të jenë në përputhje me rrjedhën e organizimit dhe zbatimit sipas planit.

Kjo mund të përfshijë shpërndarjen e fletëve të punës që ndryshojnë në kompleksitet për grupe të ndryshme të nxënësve, ose vendosjen e një sërë stacionesh pune rreth klasës, që përmbajnë një shumëllojshmëri detyrash për të zgjedhur nga nxënësit.

- **Teknologjia në klasë.** Përfshirja e teknologjisë në mësimdhënie është një mënyrë e shkëlqyeshme për të angazhuar në mënyrë aktive nxënësit, veçanërisht pasi media digjitale rrethon të rinjtë në shekullin 21. Tabelat e bardha ose pajisjet mobile interaktive mund të përdoren për të shfaqur imazhe dhe video, të cilat u ndihmojnë nxënësve që të vizualizojnë koncepte të reja

²¹ Gavoni. P, 2015.

mësimore. Të mësuarit mund të bëhet më interaktiv kur përdoret teknologjia, pasi nxënësit mund të angazhohen fizikisht gjatë mësimeve, si dhe të hulumtojnë menjëherë idetë e tyre, gjë që zhvillon autonominë.

- **Menaxhimi i sjelljes.** Zbatimi i një strategjie efektive të menaxhimit të sjelljes është thelbësore për të fituar respekt për nxënësit dhe për t'u siguruar që nxënësit të kenë një shans të barabartë për të arritur potencialin e tyre të plotë. Klasat e zhurmshme dhe përçarëse nuk inkurajojnë një ambient produktiv të të mësuarit, prandaj zhvillimi i një atmosfere respekti reciprok, përmes një kombinimi të disiplinës dhe shpërblimit, mund të jetë i dobishëm si për mësimeve, po ashtu edhe për nxënësit.²²

- **Zhvillimi profesional.** Angazhimi në programe të rregullta të zhvillimit profesional është një mënyrë e shkëlqyeshme për të përmirësuar mësimeve dhe të mësuarit në klasë. Me ndryshimin e vazhdueshëm të politikave arsimore, është jashtëzakonisht e dobishme që mësimeve të marrin pjesë në ngjarje ku mund të marrin njohuri dhe frymëzim nga mësues dhe akademikë të tjerë. Të jesh një mësimeve efektiv është një sfidë, sepse çdo nxënës është unik, megjithatë, duke përdorur një kombinim të strategjive të mësimeve mund të adresohen stilet e ndryshme të të nxënës dhe të sigurohet rrjedhë motivuese në klasë.

2. Intervistat dhe analiza

Intervistat janë realizuar në 3 shkolla të komunës së Drenasit, me nga një mësimeve në shkollë, për të parë dhe analizuar se si janë përgjigjur në pyetjet tona. Intervistat janë si në vazhdim:

- a) Intervista në SH.F. "Xheladin Gashi-Plaku" - Komoran
- b) Intervista në SH.F. "Fehmi dhe Islam Krasniqi" - Kizharek
- c) Intervista në SH.F. "Hasan Prishtina" - Llapushnik
- ç) Intervista në SH.F. "Arif Shala" - Krroticë
- d) Intervista në SH.F. "Luigj Gurakuqi" - Sankoc

Në kuadër të intervistës së strukturuar më mësimeve, në të cilën flitet për teknikat dhe strategjitë që përdoren në mësimeve, pyetjet drejtuar mësimeve janë si më poshtë:

1. Cilat janë teknikat bashkëkohore në mësimeve?
2. Si bëhet organizimi i orëve mësimeve?
3. Cilat janë format, në të cilat ju mundëson nxënësve përfshirjen në njësi mësimeve?

²² Hoti, 2014.

4. Sa minuta mesatarisht i kushtohet një nxënësi në shpjegimin e pyetjeve që bëhen për një njësi mësimore?
5. A jeni të pavarur në përdorimin e metodave në mësim apo duhet t'i përmbaheni kurrikulës?
6. Sa krijoni mundësi për punë praktike, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë më mirë njësinë mësimore?
7. Si organizohen diskutimet në Klasë?
8. Cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë në organizimin e një ore mësimore?
9. Përmendeni tri sfida dhe tri përparësi që ka sjellë kurrikula e re në aspektin e mësimdhënies dhe mësimnxënies?
10. Cilat janë metodat e vlerësimit të nxënësit nga ana juaj?

Analizë krahasuese mbi intervistën e realizuar me mësimdhënës në shkollat e lartpërmendura në komunën e Drenasit mbi temën: TEKNIKAT E MËSIMDHËNIES DHE ZBATIMI I STRATEGJIVE NË KLASË QË NXIT TË MËSUARIT.

Ngjashmëritë:

Të gjithë mësimdhënësit theksuan se përdorin të njëjtat teknika të mësimdhënies dhe bëjnë përshtatjen e strategjive me nevojat e nxënësve. Strategjitë si PUNA NË GRUPE, DRITA, DELTA, PESËVARGËSHI DHE DORA E PYETJEVE, u përmendën nga të gjithë si teknika efektive për rritjen e angazhimit të nxënësve në mësim. Gjithashtu, të gjithë mësimdhënësit theksuan rëndësinë e reflektimit në fund të çdo ore mësimore, me qëllim të përmirësimit të metodave të tyre. Njëherit, të gjithë mësimdhënësit deklaruan se varen edhe nga kurrikula mësimore për përdorimin e metodave të mësimdhënies, varësisht nga tema që e zhvillojnë. Por, mësuesit theksuan po ashtu se janë të pavarur që të bëjnë nganjëherë ndryshime nga kurrikula.

Për organizimin e orës mësimore, përgjigje të ngjashme kanë dhënë të gjithë mësimdhënësit, që organizimi i orës mësimore bëhet me EVOKIM, REALIZIM, REFLEKTIM. Po ashtu, përgjigje të ngjashme kanë dhënë edhe për metodat e vlerësimit, ku theksuan se e përdorin më shumë metodën e vlerësimit formativ të bazuar në Teste kontrolluese, ESE, Punë në grupe, hartime etj.

Dallimet:

Në lidhje me parashtimin e pyetjeve nga ana e nxënësve gjatë orës mësimore, kam vënë re dallime në përgjigje nga mësimdhënësit. Njëri deklaroi se nuk lejohet të bëhen më shumë se 3 pyetje nga një nxënës, pasi që ka shumë nxënës dhe duhet ta zhvillojë njësinë mësimore, ndërsa të tjerët theksuan se ora është 45 minuta dhe kjo varet prej tipit të orës dhe koha për shtjellimin e pyetjeve nuk është e definuar.

Dallime kanë në sfida dhe përparësi. Kështu, në deklaratimet e tyre njeri tha që mangësi është administrata e ngarkuar, intervistuesi tjetër ankohet për mungesë të teknologjisë nëpër shkolla, kurse njëri e thekson mungesën e literaturës adekuate dhe mungesën e bashkëpunimit me prindërit.

Sfidat e përbashkëta:

Të gjithë mësimmshënësit theksuan se mungesa e teknologjisë sjell vështirësi për implementim më profesional në kohën bashkëkohore. Po ashtu, numri i madh i nxënësve në klasë u përmend që sjell vështirësi në shkëmbimin e pyetje-përgjigjeve, me pretekstin se duhet të realizohet edhe njësi mësimore e përcaktuar për atë ditë në bazë të planifikimit të orës mësimore. Gjithashtu, sfida tjetër dhe shumë e rëndësishme është edhe mos bashkëpunimi prindmësues, gjë që sjell vështirësi në edukimin dhe nxënien e dijes nga nxënësit.

Përfundimi

Pavarësisht dallimeve, të gjithë mësimmshënësit janë të vetëdijshëm për rëndësinë e teknikave të mësimmshënësis dhe stategjive që duhet të përdoren në mësimmshënësi. Njëherit, të gjithë deklaruan se kërkojnë mënyra më të sofistikuar që këto metoda t'i praktikojnë në perfeksion dhe me anë të metodës krahasuese të punojnë së bashku për identifikimin e përbashkët në praktikë. Shkëmbimi i ideve mes kolegëve ju ndihmon mësimmshënësve për të rritur cilësinë e mësimmshënësis në zbatimin e stategjive dhe metodave të mësimmshënësis.

Conclusion

Teaching techniques and strategies that teachers use during the teaching process play an important role not only in terms of preparing students but also in gaining the necessary experiences of teachers. Teaching aims to help each student grow as much as he or she has specific skills and talents but this is achieved by using effective methods in discovering students' abilities. According to the research, I have come to the conclusion that teachers who use effective teaching strategies take into account multiple aspects of students to meet their best educational needs for the development of students because the use of appropriate pedagogical and methodological techniques affects effective teaching and learning. Also, during the findings in various researches by different authors, and from the interviews taken from the teachers, we finally say that working in groups is a powerful learning activity where the essential element is the work in cooperation. However, in contrast to individual work, the process of cooperation influences the learning results and increases the motivation of the students to learn and in this way the classroom environment becomes positive and encourages learning. Therefore, the chosen topic **TECHNIQUES AND IMPLEMENTATION OF EFFECTIVE**

STRATEGIES IN CREATING A POSITIVE ENVIRONMENT IN THE CLASSROOM THAT ENCOURAGES LEARNING was intended to identify the methods and strategies that teachers use to achieve success in teaching and learning.

Recensentë:

Prof. dr. Besa Dogani

Prof. dr. Besa Havziu

Referencat:

- Aferdita Deva - Zuna. (2009). *Bashkëpunimi shkollë, familje, komunitet*. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Demokratik, Q. p. (2008). *Mësimdhënia dhe të nxënësve ndërvetës: Modele për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve, cikli fillor për klasat 1-5.*, (p. 22). Tiranë.
- Dërvodeli, D. J. (2014). *Hyrje në Pedagogji*. Prishtinë: UP
- Gavoni. P. (2015). *The Art of Effectively Communicating With Students (and Staff!)*. Paris.
- Hoti, P. D. (2014). *Arsimi tërë jetësor-sfidë apo realitet*. Prishtinë: UP.
- Latifi, F. (2015). *METODAT BASHKËKOHORE TË MËSIMDHËNIES SË GJUHËS SHQIPE NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME TË ULËTA*. Prishtinë: AAB.
- MASHT. (2017). *Korniza Korrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës/Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë*.
- Musai, B. (2005). *Mësimdhënia dhe të nxënësve ndërvetës*. Tiranë: PEGI.
- Musai, B. (2003). *Metodologjia e Mësimdhënies*. Tiranë.
- Salihu, L. Z. (2008). *Të drejtat e fëmijës dhe etika e mësimdhënësit*. Prishtinë: Qendra për arsim e Kosovës.
- Schader, B. (2015). *Strategji dhe teknika e të mësuarit*. Cyrih.
- Selmani Lefteri, M. A. (2006). *Konceptimi dhe organizimi i veprimtarisë mësimore-edukative në arsimin parashkollor*. Tiranë: GEER.
- Zeneli, I. (2006). *Bazat psikologjike të të nxënësve: Mekanizmat e funksionimit të mendjes*. Prishtinë.